



Qendra për Arsim e Kosovës  
Kosova Education Center

**KEC**

**Kodi: 025**

## **EDUKIMI KUNDËR KORRUPSIONIT (EKK)**

### Qëllimet e Programit

Me përvetësimin e këtij Programi pjesëmarrësit duhet të jenë në gjendje:

- Të identifikojnë format e ndryshme të paraqitjes së korrupsionit në shoqëri, si dhe strategjitë për luftimin e tij.
- Të përfshijnë idenë e luftës kundër korrupsionit në kurrikulin e tyre mësimor.
- Të krijojnë klasa që nxisin diskutim të hapur dhe të përgjegjshëm, që i kontribuojnë vetëdijësimin të nxënësve për ndikimin e korrupsionit në pengimin e zhvillimit të shoqërive demokratike.
- Të krijojnë një mjedis të përshtatshëm në klasë përmes përdorimit të teknikave të shumëllojshme e të efektshme, të cilat ndihmojnë nxënësit në procesin e përvetësimin të njohurive për të mos rënë pre e dukurive korruptive.
- Të organizojnë aktivitete ekstra-kurrikulare me nxënës për sensibilizimin e opinionit publik.
- Të bëhen burim përvoja dhe njohurish për mësimdhënësit e tjerë.

### Përmbajtja

1. Përkufizimi dhe format e paraqitjes së korrupsionit. Shkaqet dhe pasojat e paraqitjes së tij. Strategjitë për luftimin e korrupsionit. Korrupsioni në sistemin e arsimit dhe mënyrat e luftimit të tij. Përfshirja e idesë së luftës kundër korrupsionit në kurrikulin mësimor të lëndëve të ndryshme. Studimet e rastit. Aktivitetet për luftimin e paragjykimeve. Roli i institucioneve, mediave dhe OJQ-ve në luftimin e korrupsionit. Përgatitja e mësimëve model në grupe lëndore dhe prezantimi i tyre.

### Grupi i synuar

Nga ky program mund të përfitojnë mësimdhënësit e lëndëve shoqërore të të gjitha niveleve të shkollimit, administratorët e shkollave, hartuesit e kurrikulave dhe të teksteve

shkollorë, zyrtarët e arsimit, si dhe të gjithë ata të cilët tregojnë interesim për të përfituar njohuri për edukimin kundër korrupsionit.

#### Forma e organizimit/ Kohëzgjatja

Programi organizohet në formë të seminarit 3-ditorë dhe përmban 25 orë trajnim, duke përfshirë orën e monitoruar. Pas përfundimit të seminarit mësimdhënësit do monitorohen në klasat e tyre.

#### Certifikimi

Kusht për certifikimin për pjesëmarrje është përcjellja me rregull e seminarit dhe monitorimi i orës mësimore.